

AKT THEMELIMI
i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar
“Biomar Medical”

Sot, me 15.03.2022 , ne te nenshkruarit: Atilla Kavrak i datelindjes 10.12.1975 i pajisur me karte identiteti H51210166F, Ardjan Alimeri i datelindjes 12.07.1969 i pajisur me karte identiteti G90712054C, regjistrojme nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin “Biomar Medical” Sh.p.k.

Neni 1

Personat e siperpermendur, me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi, vendosen te krijojne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin “ Biomar Medical” Sh.p.k., me kapital themeltar 2 000 000 Leke.

Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane ne adresen: Unaza e Re, Rruga Teodor Keko, Kompleksi Romario, Shkalla 1, Kati i dyte, Nr. 3

Ortaket e kesaj shoqerie do te jene: Atilla Kavrak, Ardjan Alimeri.

Shoqeria “Biomar Medical” Sh.p.k., ka te drejte te krijojte filiale brenda dhe jashte Shqiperise, ne menytrat dhe me kohezgjatje ashtu sikunder e konsideron te arsyeshme, dhe me miratimin e organeve kompetente.

Neni 2

Kompania gezon statusin e personit juridik.

Aktivitetet e saj do te kryhen sipas dispozitave te ketij akti, statutit dhe legjislacionit aktual. Statuti i kompanise eshte i bashkelidhur ketij akti te themelimit dhe formon nje pjese integrale me te.

Neni 3

Veprimtaria e kompanise si nje entitet juridik fillon me miratimin e krijimit te saj nga ana e organeve kompetente te shtetit dhe do te jete e vlefshme per nje periudhe te pacaktuar kohe.

Shoqeria perfundon aktivitetet e veta me vendimarrje unanime nga te gjithë ortaket e saj.

Neni 4

Objekti i shoqerise : Shitje me shumice dhe pakice e suplementeve mjekesore dhe farmaceutike. Gjithashtu shoqëria mund te ushtroje edhe çdo lloj aktiviteti tjeter te pashprehur me siper, qe lejohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.



Neni 5

Kapitali fillestar i kompanise do te jete 2 000 000 leke te ndare ne 2 kuota me vlere nominale 1 000 000 leke per kuote ku:

Atilla Kavrak zoteron 1 kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit me vlere 1 000 000 leke.

Ardjan Alimeri zoteron 1 kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit me vlere 1 000 000 leke.

Kapitali themelor eshte depozituar nga ortaket ne emer te shoqerise. Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet, pervec ketij akti themelimi, me normat e vendosura ne Statut, kundrejt nenshkrimt te ortakeve, dhe aprovimit nga Qendra Kombetare e Biznesit, ditën qe do te marre cilesine e personit juridik.

Neni 6

Fitimi neto qe do te realizohet nga aktivitetet e kompanise do te ndahet midis ortakeve ne perpjesetim me aksionet e tyre ne kompani. Çdo anetar eshte i lire per te marre pjesen e vet te fitimeve ne nje llogari bankare brenda apo jashte shtetit Shqiptar.

Neni 7

Per borxhet qe mund te ezistojne ne te ardhmen ndaj paleve te treta gjate aktivitetit, shoqeria do te pergjigjet vetem me kapitalin e saj themeltar. Anetaret nuk jane pergjegjes per borxhet e shoqerise me pronen e tyre.

Neni 8

Anetaret jane te detyruar per te ruajtur natyren konfidenciale te aktivitetit te shoqerise.


Neni 9

Marredheniet e punes ne shoqeri apo deget e saj rregullohen me kontraten e punes ne lokalitetin e tyre dhe ne menyren e percaktuar nga ana e shteteve perkatese.

Neni 10

Rregullime me te detajuara mbi organizimin e kesaj shoqerie jane te percaktuara ne Statutin e saj. Themeluesit pas leximit me kujdes te Aktit te Themelimit e nenshkruan si te sakte dhe ne perputhje me vullnetin e tij.

Ortaket Themelues**Atilla Kavrak**

Atilla Kavrak


Ardjan Alimeri

Ardjan Alimeri
